



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, datë 29.05.2023

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
VORË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 3, DATË 17.05.2019
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 3, datë 17.05.2019 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vorë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vorë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 33 datë 28.04.2023, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Vorë, të miratuar me Vendimin Nr. 3, datë 17.05.2019, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në:
 - *Dokumentin e Rregullores së Planit:*
 - Pas nenit 19 “Përcaktimi i njësive strukturore për të cilat hartohet PDV”, shtohet neni 19/1 “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm”;
 - Pas nenit 23 “Njësiti strukturore me përdorim bujqësi dhe natyrë”, shtohet neni 23/1 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror” dhe neni 23/2 “Kushte për objektet ekzistuese në sistemin bujqësor dhe natyror”;
 - Në nenin 38 “Koefficienti i shfrytëzimit të tokës (KSHT)”, pika 5 ndryshon përmbajtje.
 - Pas nenit 43 “Distanca”, shtohet neni 43/1 “Madhësia minimale e parcelës”;
 - Pas nenit 44 “Vija e ndërtimit”, shtohet neni 44/1 “Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A,B dhe C”;
 - *Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;*


- *Ndryshime të "Hartës së infrastrukturës së transportit të propozuar të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vorë".*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Vorë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Vorë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Vorë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

